

## Dokument politik i Grupit Politik të Punës për Statutin

### I. Veprimtaria e Grupit Politik për Statutin

**Mandati:** Grupi Politik për Statutin ka punuar brenda mandatit që i përcaktoi Kryesia e Partisë. Detyra e GP ishte të mbledhte dhe të konsultonte çdo propozim të paraqitur nga forume, individë apo flukse në parti për ndryshime të nevojshme statutore dhe mbi këtë bazë të hartonte rekomandimet për ndryshime në Statutin e Partisë.

**Synimet:** Gjithë procesi i konsultimit dhe miratimit të ndryshimeve statutore është udhëhequr nga **dy synime kryesore**. Primar është **krijimi i hapsirave dhe garancive demokratike në parti dhe përfshirja në vendimmarrje e antarësisë**. Një tjetër synim është **rritja e efektivitetit të partisë** si një organizatë që synon të vërë në jetë aksionin saj politik dhe intensifikimin e komunikimit me elektoratin për të arritur qëllimin madhor - zgjerimin e mbeshtetjes politike.

**Burimet:** Grupi i Punës ka konsultuar ide dhe propozime që vijnë nga burime të ndryshme. Burimet kryesore janë: **i)** propozimet që kanë dalë gjatë procesit të analizës dhe konsultimit. Demokratët kanë shprehur opinione dhe kanë bërë propozime konkrete për mënyrën se si të zgjerohet demokracia në parti dhe të forcohet efektiviteti i saj si organizatë; **ii)** modelet që kanë rezultuar të suksesshme nga partitë simotra në Evropë (DCU, Konservatorët Britanik dhe FIDESZ Hungarez; **iii)** propozimet që vijnë nga dy flukse të ndryshme që përbëhen nga individualitete politike të PD-së dhe që janë kristalizuar në një platformë politike dhe në një draft- statut krejt të ri; **iv)** propozime individuale që janë adresuar tek anëtarët e Grupit të Punës. Këto propozime vijnë nga anëtarë të thjeshtë, Kryetarë Degësh, apo edhe nga figura të rëndësishme që kanë dëshmuar angazhim për të kontribuar në këtë proces të rëndësishëm për PD-në.

**Metoda:** Grupi i Punës, përveç shqyrtimit të propozimeve të dokumentuara, ka bërë konsultime me individë me përvojë politike të gjatë në organizimin e partisë, me njohës të çështjeve statutore, me propozues të ndryshëm, si dhe me profile të spikatura dhe të zëshme në debatet politike të partisë. Grupi i Punës ka shqyrtuar me kujdes çdo propozim, për t'i sistemuar dhe organizuar ato si koncepte politike. Nga kjo bazë, janë formuluar rekomandimet me opsionet që, pas miratimit politik nga Kryesia dhe Këshilli Kombëtar, do të çojnë drejt një draft-statuti të vetëm ku të konvergojnë të gjitha prurjet, qasjet dhe vështrimet e ndryshme.

## II. Koncepte politike që duhet të avancohen me statutin e ri

### 1- Afrimi i vendimmarrjes tek anëtarësia.

Ka pasur një kërkesë të zëshme për të zgjeruar praktikën e votimit nga anëtarësia, jo vetëm për Kryetarin e PD-së, por edhe për funksione të tjera politike. Propozimet kanë qenë që kryetarët e GS, kryetarët e degëve, si dhe kandidatët për deputetë dhe kryetarë bashkish të votohen nga anëtarësia. Rezistenca ndaj kësaj praktike mbështetet në traditën ideologjike dhe institucionale të djathtës në përgjithësi edhe në vlerësime të natyrës politike për cilësinë/profilin e kandidaturave. Një tjetër argument refuzues është dhe çështja e listave të antarësisë. Gjatë analizës, ka pasur dhe propozime krejtësisht të kundërta që mbështesin idenë centraliste që kryetarët e degëve të emërohen nga Kryetari i Partisë.

Sa i përket përdorimit të primareve, votës së antarësisë për të seleksionuar kandidatët për zgjedhje, vështrimet kanë qenë më tepër të natyrës politike. Përvoja e mëparshme të PD-së, kur kandidaturat janë zgjedhur nga Konferencat / Aktivitetet e Degëve nuk vlerësohet e përshtatshme, pasi mbart riskun e përçarjeve që, me kulturën e pakët politike dhe demokratike, nuk shërohen lehtë. Po kështu, vlerësohet se forca e PD-së qëndron te kualiteti i figurave konkurrese që janë në gjendje të sigurojnë mbështetjen politike në elektorat përtej asaj të partisë.

Duke patur parasysh këto, në statutin e ri të parashikohet:

- Aplikimi i praktikës së votimit “një anëtar një votë” edhe për drejtuesit e Grupseksioneve; Anëtarësia të zgjedhë jo vetëm kryetarin dhe sekretarin e seksionit, por edhe kryetarin e Grupseksionit. Ky është një avancim i rëndësishëm i aplikimit të këtij parimi. Ka pasur propozime që kjo praktikë të aplikohet edhe për Kryetarin e Degës. Por, në kushtet e sotme, niveli i grupseksionit është më i përshtatshëm për të aplikuar këtë parim/praktikë.
- Përfshirja e antarësisë në procesin e përzgjedhjes së kandidatëve për deputetë. Kandidaturat që plotësojnë kriteret të kalojnë në filtrin e votës së antarësisë, përpara se institucionet qendrore, Kryesia dhe Këshilli Kombëtar të marrin vendimin përfundimtar. E drejta për t’u konsideruar si kandidat, apo për të propozuar kandidat të mos ketë asnjë kufizim. Pretendentet për kandidat, pasi të kenë kaluar në filtrin e vlerësimit të Komitetit të Seleksionimit të Kandidaturave të votohen nga anëtarësia e degëve ku ata preferojnë të kandidojnë.
- Organet qendrore, Kryesia dhe Këshilli Kombëtar të kenë mundësi që të propozojnë kandidaturat e tyre alternative për funksione që janë brenda kompetencës së tyre. Propozimet alternative nga këto organe të bëhen mbi një mbështetje paraprake të konfirmuar jo më pak se 15% të numrit të anëtarëve;
- Dhënia e kompetencave të qarta/specifike organeve qendrore (Kryesi, Këshill Kombëtar dhe Kuvend Kombëtar) për vendimarrje të rëndësishme politike të partisë. Këtu futet miratimi i

propozimeve për kandidatura, për koalicionet dhe aleancat, për strategjitë dhe programet politike dhe elektorale.

## **2- Efektiviteti i funksionimit të strukturës së partisë.**

Partia, së pari, duhet të funksionojë si një organizëm efektiv që përmbush misionin e saj politik. Nga analiza janë vënë në dukje probleme të shumta që lidhen me përgjegjësitë në zbatimin e detyrave, në drejtimin e aksionit politik, në komunikimin me antarësinë dhe me elektoratin, etj.

Puna e territorit në gjithë përvojat elektorale, por edhe menaxhimi i antarësisë ka rezultuar më efektiv në nivelin e GS. Po kështu, kryesitë e degëve perceptohen gjerësisht si joefektive. Ato konsumojnë shumë retorike dhe ndajnë pak përgjegjësi direkte individuale. Performanca individuale nuk matet. Përgjegjësia fshihet pas funksioneve kolegjiale. Propozimi kryesor ka qenë që të kalohet në kryesi degësh mbi baza funksionesh. Edhe përvojat e partive të tjera tregojnë për organe drejtuese më të vogla që janë të afta të marrin vendime dhe ndajnë përgjegjësi.

Për këtë në statutin e ri të parashikohet:

- Zgjerim të funksioneve, përgjegjësive dhe kompetencave të Kryetarit të Grupseksionit. Pas zgjedhjes sipas praktikës “një anëtar një votë” Kryetari i grupseksionit të jetë automatikisht edhe anëtar i Kryesisë së Degës, si dhe të ketë kompetencën që, mbi bazën e performancës, t’i propozojë Kryesisë së Degës shkarkimin dhe komandimin e Kryetarit të Sekasionit.
- Kryesia e Degëve të Partisë të jetë mbi bazat e funksioneve, Kryesia e degës të përbëhet nga Kryetarët e Grupseksioneve të Degës, nga Sekretari i Degës që emërohet nga Kryesia Qëndrore, si dhe nga Sekretariati FunkSIONAL që të zgjidhet nga Konferenca e Degës. Sekretariati funksional të jetë me numër të kufizuar, vetëm katër sekretarë që mbulojnë çështjet e organizimit, burimeve njerëzore, marrëdhënjeve me publikun dhe zgjedhjeve. Pjesë e kryesisë së degës të jenë edhe nënkryetarët e degës. Duke qenë se kryetarët e GS forcohen shumë, duhet forcuar edhe pozicioni i Kryetarit të degës, duke i dhënë kompetencën që të emërojë ai Nën/Kryetarët e Degës. Secili prej tyre të jetë përgjegjës për territorin e një KZAZ-je.
- Përfshirjen e performancës si kriter vlerësimi. Në statut të vendoset parashikimi i performancës si kriter vlerësimi. Mbi këto kriter të bazohen propozimet për promovim apo për shkarkim të funksionarëve politikë.
- Rregullimin e institucionit “Kolegji i Kryetarëve”, i përbërë nga kryetarët e Degëve, shoqëruar me funksionet përkatëse. Kjo trupë politike ka funksionuar shumë mirë sidomos në shqyrtimin e nismave dhe aksionit politik të partisë dhe në ndjekjen dhe zbatimin e detyrave në territor. Kjo praktikë të rregullohet me parashikimet statutore.

- Zvogëlimi i numrit të anëtarëve të trupave kolegjiale qendrore dhe vendore (Kryesi e PD-së, Kryesi e Degëve).

i) Kalimi në Kryesitë e Degëve mbi bazën e funksioneve. Kjo rrit efektivitetin e tyre, mundëson ndarjen e qartë të detyrave dhe mbajtjen e përgjegjësisë.

ii) Kryesia qendrore propozohet të jetë më e vogël në numër dhe të përbëhet nga: Kryetari i Partisë, Nënkryetarët, Sekretari i Përgjithshëm dhe Sekretarët Funkcionalë (jo më shumë se katër) të cilët zgjidhen nga Këshilli Kombëtar mes dy kandidaturave alternative që propozon Kryetari i Partisë, si dhe nga 10-15 anëtarë të tjerë që dalin më të votuar nga një listë shumëemërore, që i propozohet Këshillit Kombëtar nga Kryetari i Partisë.

- Funksionin dhe detyrat e Koordinatorit Rajonal në vend të trupës kolegjiale që ka statuti ekzistues. Trupa e deri sotme nuk ka funksionuar. Ajo është konceptuar në kohën kur u kalua në sistemin elektoral proporcional rajonal, në kushtet kur kishim një tjetër ndarje administrative territoriale, si dhe kur ishim në pushtet. Në atë kohë funksionimi i kësaj trupe rezultoi problematik dhe u perceptua si një instrument parcelizimi dhe dominimi të pushtetit nga autoriteti më i lartë qendror. Gjatë opozitës nuk ka funksionuar.

Koordinatori rajonal të emërohet për periudhë dy-vjeçare nga Kryetari i Partisë dhe të kryejë detyra të caktuara nga ai dhe që lidhen me koordinimin e veprimtarive politike të PD në territorin e qarkut, me fushatat elektorale për zgjedhjet e përgjithshme dhe ato vendore, si dhe me përfaqësimin politik të partisë në nivelin e qarkut. Koordinatori Rajonal nuk zëvendëson rolin e përgjegjësive politik që operojnë në territorin e qarkut me mandate të përcaktuara nga Kryesia dhe /ose nga Kryetari i Partisë. *Funksionet e Koordinatorit Rajonal të jenë ta natyrës së funksioneve të sekretarit të një dege.*

- Rishikimin e organizmave qendrore dhe lokale Departamente dhe KOP.

i) Në çdo Degë të krijohet Bordi Këshillimor, ose Këshilli Politik. Anëtarët e bordit/Këshillit janë koordinatorë, ose Këshilltarë / Përgjegjës politik për fusha të caktuara. Këta zgjidhen nga Kryesia e Degës dhe janë anëtarë të mbledhjes së Kryesisë së Degës pa të drejtë vote. Bordi / Këshilli të ketë një numër të kufizuar fushash/koordinatorësh. Numri i tyre të propozohet nga Dega dhe të miratohet nga Kryesia Qendrore.

ii) Departamentet qendrore të përcaktohen si numër nga Kryesia. Funksionet e departamenteve nuk ndryshojnë, vetëm të qartësohen më shumë (sa të jetë e mundur). Drejtuesit e departamenteve zgjidhen nga Kryesia e Partisë/Këshilli Kombëtar (*kjo për t'u diskutuar*). Profili i tyre të jetë politik

iii) Komiteti i Orientimit të Politikave. Mban të njëjën mënyrë organizimi dhe funksionimi. Theksohet më shumë natyra e tij si një forum që bashkon dhe mundëson vjeljen e kontributeve

një rregulloreje që do të miratohet nga Këshilli Kombëtar. Komiteti i Kandidaturave ngrihet me vendim të Kryesisë së Partisë sipas afateve të përcaktuara.

Ky institucion i ri i partisë vjen, si një propozim racional dhe i zbatueshëm nga propozimet që përmban projekt-statuti i shpallur publikisht nga dy anëtarë të Këshillit Kombëtar, si dhe përfaqëson në kushtet tona modelin origjinal që aplikon partia Konservatore Angleze. Procesi i përzgjedhjes së kandidaturave të jetë: i hapur për propozime; i bazuar në kritere të shpallura; transparent dhe me kohën e domosdoshme për garuesit; i arsyetuar në opinionin/preferencën e shprehur nga votimi i antarësive së degëve; në respekt të kritereve të karrierës në parti; i konsultuar politikisht nga Kryesia e Partisë; dhe i votuar përfundimisht në Këshill Kombëtar / Kuvend Kombëtar.

#### 4 - Çështje të tjera etike / politike

- Pastërtia e Figurës - Parashikimi në statut i Komisionit të Etikës dhe i rregullores së funksionimit dhe standarteve etike të tij. Përbërja dhe Rregullorja e Komisionit të Etikës të miratohet nga Këshilli Kombëtar. Rregullorja e funksionimit dhe standarteve etike e këtij komisioni të vendos si nivel minimum detyrimet ligjore për dekriminalizimin, lustracionin dhe pastërtinë e figurës.
- Garantimi i karrierës - Në rregulloren e brendshme të parashikohen kriteret minimum të karrierës që duhet të përmbushë çdo kandidat për funksione politike në parti. Këto kritere duhet që të kenë referencë kohëzgjatjen e antarësimit, kontributin në fushata elektorale, aktivizmin në jetën politike dhe publike të vendit.
- Ideologjia dhe Etika - Përfshirja në “përkufizimi politik dhe qëllimet” të deklarimeve më të qarta për bazën ideologjike të djathtë të partisë, për vlerat etike si besimi tek zoti, mbrojtja e vlerave të familjes, shenjtëria e pronës, dhe të misionit dekomunistizues dhe antidiktatorial të PD-së.